



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 22.11.2023, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Klotilda Bushka – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Seancë dëgjimore për shqyrtimin e projektligjit “Për buxhetin e vitit 2024” me:

Avokatin e Popullit

Ministrinë e Shtetit për Pushtetin Vendor

Shoqatën për Autonomi Vendore

Shoqatën e Bashkive të Shqipërisë

Marrin pjesë:

Klotilda Bushka, Jurgis Çyrbja, Klevis Xhoxhi, Toni Gogu, Damian Gjikhuri, Saimir Hasalla, Aurora Mara, Eduard Ndreca, Bardhyl Kollçaku, Olta Xhaçka, Petro Koçi, Xhemal Qefalia, Denis Deliu, Arkend Balla, Dhurata Çupi, Greta Bardeli, Fatmir Xhafaj, Gledis Çeliku, Oerd Bylykbashi, Erisa Xhixho, Dashnor Sula, Pandeli Majko, Ermonela Felaj dhe Gerta Duraku.

Mungojnë:

Enkelejd Alibeaj, Bledion Nallbati, Gazment Bardhi, Saimir Korreshi, Elda Hoti dhe Fatmir Mediu.

Të ftuar:

Erinda Ballanca – Avokate e Popullit

Ahmet Prençi – komisioner në institucionin e Avokatit të Popullit

Ermonela Ruspi – komisionere në institucionin e Avokatit të Popullit
Vilma Shurdha – komisionere në institucionin e Avokatit të Popullit
Olta Aliaj – komisionere në institucionin e Avokatit të Popullit
Fatbardh Zenelaj - sekretar i Përgjithshëm i Avokatit të Popullit
Arbjan Mazniku- ministër i Shtetit për Pushtetin Vendor
Ilir Xhakolli - kryetar i Bashkisë së Pogradecit, Shoqata për Autonomi Vendore
Gledian Llatja - kryetar i Bashkisë së Elbasanit, Shoqata për Autonomi Vendore
Juliana Memaj - kryetare e Bashkisë së Dimalit, Shoqata për Autonomi Vendore
Andi Seferi – nënkryetar i Bashkisë së Tiranës, Shoqata për Autonomi Vendore
Adelina Farriçi – drejtore ekzekutive e Shoqatës për Autonomi Vendore
Alma Selami - kryetare e Këshillit të Qarkut të Dibrës
Gentian Opre - drejtor i Analizës dhe Programimit Buxhetor në Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë
Fran Brahimi – drejtor i Financave Vendore në Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

HAPET MBLEDHJA

Klotilda Bushka - Mirëdita!

Nisim mbledhjen për shqyrtimin e projektbuxhetit të vitit 2024. Komisioni ynë e ka miratuar në parim këtë projektligj. Ne si komision kemi zhvilluar dëgjesat me institucionet publike, institucionet e drejtësisë dhe institucionet e pavarura. Sot vijojmë shqyrtimin e projektligjit “Për buxhetin e vitin 2024” me dy dëgjesat e fundit, por jo më pak të rëndësishmet.

Ndërkohë, plotësohet kuorumi i nevojshëm për vlefshmërinë e kësaj mbledhjeje. Bashkë me ne janë edhe kolegët e Komisionit të Ekonomisë dhe Financave, që kanë interes të marrin pjesë në këtë dëgjesë, kryesisht për çështjet e pushtetit vendor.

Sot do të realizojmë seanca dëgjimore me Avokatin e Popullit, me Ministrin e Shtetit për Pushtetin Vendor, me Shoqatën për Autonomi Vendore dhe Shoqatën e Këshillave të Qarqeve të Shqipërisë.

Seancën dëgjimore do ta fillojmë me Avokaten e Popullit, zonjën Ballanca, e cila është e shoqëruar nga komisionerët: Ahmet Prençi, Ermonela Ruspi, Vilma Shurdha, Olta Aliaj dhe Fatbardh Zenelaj, sekretari i Përgjithshëm. Ndërkohë *online* kemi edhe përfaqësuesit e Ministrisë së Financave. Relatorë janë zoti Samir Hasalla dhe zoti Klevis Xhoxhi.

Sipas rregullit, zonja Ballanca, do ta merrni fjalën për të prezantuar treguesit e realizimit financiar për vitin 2023, si i adreson nevojat tuaja buxheti i vitit 2024 dhe çfarë kërkesash keni për komisionin.

Erinda Ballanca - Faleminderit!

E nderuar kryetare,

Të nderuar anëtarë të Komisionit të Ligjeve,

Të nderuar të ftuar të Komisionit të Ekonomisë,

Në fakt, ne i kemi paraqitur me shkrim disa nga objeksionet tona, por në mënyrë të përmbledhur unë do të paraqes arsyet pse kërkojmë një përmirësim në rritje të buxhetit.

Së pari, dua të theksoj se ky buxhet, në krahasim me buxhetin e vitit të kaluar, vjen në rritje për institucionin e Avokatit të Popullit, por nuk i plotëson të gjitha nevojat që ne kemi. Praktikisht, kemi një diferencë në fondin e pagave për sa i përket numrit që është miratuar, pra ne kemi një numër total të miratuar nga ana e Kuvendit për stafin që mund të marrim, e cila për

fondin e pagave është në vlerën 9,97 milionë lekë dhe për fondin e sigurimeve shoqërore është në vlerën 816 mijë lekë. Këto diferenca për numrin dhe fondin e pagave janë të miratuara tashmë nga ana e Kuvendit.

Me Ministrinë e Financave ne kemi diskutuar në mënyrë të vazhdueshme, pasi ajo pretendon se këto janë fonde që mbeten për shkak të mosplotësimit të vakancave, duke qenë se herë pas here ka lëvizje të stafit, por edhe për shkak të procedurave mund të ketë një periudhë kohore që ka një pozicion vakant. Në diskutimet që kemi bërë pretendimi i tyre është se, edhe për shkak të realizimit që kemi në lidhje me këto dy zëra në vite, kjo vlerë nuk duhet në mënyrë thelbësore dhe mund të rikuperohet për shkak të këtyre vakancave. Gjithsesi, në zërin 600 deri në momentin aktual e kemi të realizuar në një nivel të kënaqshëm dhe deri në fund të vitit do ta kemi të realizuar në masën 97,6%. Pra, është një realizim pothuajse tërësor. Po ashtu deri në fund të vitit realizimi i fondit të pagave do të jetë në masën 96,91%, sepse kuptohet do të merren edhe pagat e muajit nëntor dhe dhjetor.

Në tërësi i gjithë buxheti ynë, i miratuar për planin e vitit 2023, deri në fund të vitit do të realizohet në masën 96,64%. Ka një diferencë të vogël, prej 4%, në mosrealizimin e buxhetit, e cila lidhet me zërin 602, që janë shpenzimet operative, për të cilat ka herë pas here diferenca në lidhje me shpenzimet që kemi realizuar.

Ndërsa për sa u përket zërave të tjerë, ato i kemi realizuar në masë shumë të madhe. I vetmi zë që nuk është realizuar dhe ka një përqindje të ulët realizimi, është zëri 606, i cili ka të bëjë me pagesat kalimtare, të cilat jepen në momentin e largimit të disa personave nga institucioni. Për shkakë që ju i dini qoftë Avokati i Popullit, qoftë dy nga komisionarët janë me mandat të mbaruar dhe parashikohet një fond për pagesat kalimtare të tyre. Duke qenë se nuk ka ndodhur përzgjedhja e stafeve të reja apo e titullarëve të rinj, ky zë është realizuar vetëm në masën 42%, pra nuk është realizuar në të gjithë vlerën e plotë.

Kërkesa jonë kryesore kishte të bënte me përmirësimin e këtij zëri.

Nga ana tjetër, siç e dini, Avokati i Popullit ka qenë pjesë e një vlerësimi të thelluar nga ana e Komisionit Europian për vlerësimin që i është bërë institucionit të të drejtave të njeriut. Unë me shumë krenari them që përputhshmëria e nivelit të aktivizmit të Avokatit të Popullit dhe kritereve të tjera që Avokati i Popullit duhet të plotësojë, sipas “Parimeve të Parisit” dhe sipas “Parimeve të Venecias”, është pothuajse e plotë me disa kërkesa që janë bërë nga ana e Komisionit Europian për përmirësimet, ku një pjesë e tyre ka të bëjë me ndryshime ligjore (ne po

përgatitim një paketë që do t'jua paraqitim juve, si komision) dhe më të rëndësishmet kanë të bëjnë me ndryshimet që ne do të kemi në buxhet.

Ky vlerësim i BE-së njeh përmirësimin e buxhetit të Avokatit të Popullit gjatë vitit të kaluar, por kërkon në mënyrë thelbësore edhe dy gjëra, që ne duhet t'i kemi: së pari, në mënyrë thelbësore kërkohet që të gjithë punonjësit që ne i kemi me kontratë, pra janë 10 punonjës të Avokatit të Popullit, që janë në zyrat rajonale dhe staf me kontratë, për të cilin ne buxhetohemi çdo vit me një fond të posaçëm nga ana e qeverisë, të futen brenda strukturës së institucionit të Avokatit të Popullit. Për këtë ne kërkojmë vëmendjen tuaj, në mënyrë që kjo gjë të realizohet.

Nga ana tjetër, gjithashtu konsiderohet se numri dhe stafi i personave që ne kemi nuk është i mjaftueshëm për të ushtruar tërësisht në mënyrë të plotë mandatin tonë. Në këto kushte, edhe me të reja e fundit, që kanë të bëjmë si me marrëveshjen e firmosur midis Shqipërisë dhe Italisë, po ashtu edhe me problematikat që ne mund të kemi me migracionin, nga ana jonë kërkohet të kemi një numër shtesë në stafin e mekanizmit për parandalimin e torturës. Kjo është një kërkesë, që ne e kemi paraqitur dhe mendojmë se është e domosdoshme për të ushtruar atë mandat që ne do të na duhet ta ushtrojmë edhe në kuadër të ndryshimeve të reja që janë bërë, edhe lëvizjeve më të mëdha të emigrantëve që pritet të kemi në muajt në vazhdim, edhe për shkak të luftës në Gaza, edhe për shkak të çështjeve të karakterit gjeopolitik. Ne vlerësojmë se është i nevojshëm shtimi i stafit me ndihmëskomisioner në këtë grup.

Unë dua t'ju them që ne mbështetemi nga UNHCR-ja prej disa vitesh me dy anëtarë stafi, vitin e kaluar u bënë tre për të monitoruar kufijtë. Pra, dua të them se numri i stafit që ne kemi aktualisht nuk është i mjaftueshëm dhe, nëpërmjet projekteve me UNHCR-në, kemi marrë staf, ata paguajnë staf për të monitoruar kufijtë dhe për të parë lëvizjet e emigrantëve të paligjshëm në vend. Pikërisht për shkak të kësaj marrëveshje dhe rolit që ne kemi, jemi shumë të vlerësuar si nga Frontex-i, ashtu edhe shoqatat e të drejtave të njeriut për punën që kemi bërë në ruajtjen apo monitorimin e të drejtave të emigrantëve në kufi. Por mbetet, gjithmonë, problem shumë i rëndësishëm çfarë ndodh me trafikun, pra trafikimin brenda për brenda, dhe çfarë ndodh më tej me garantimin e të drejtave të tyre për azil.

Kuptohet, edhe marrëveshja e re që është lidhur nga qeveria mund të sjellë nevojën për një vëmendje më të shtuar në lidhje me këtë pikë. Nga ana tjetër, vitin e kaluar ju me të drejtë na keni akorduar burime njerëzore shtesë për IT-në, një person shtesë. Ne kemi pasur në strukturë vetëm një shef sektori, që merrej me këtë fushë, por është shtuar edhe një specialist. Por, duke

qenë se niveli i pagave të personave që punojnë tek Avokatit të Popullit me atë të punonjësve të AKSHI-t dhe të strukturave të tjera, të cilat janë të drejtuara ose të organizuara në nivel qendror nga qeveria, është shumë i ndryshëm, me kemi probleme thelbësore në marrjen në punë të stafit në lidhje me këtë çështje. Ndaj, duhet të gjendet një formulë tjetër që të na mundësojë marrjen në punë të stafeve për informacionin dhe teknologjinë, për faktin se ne, në përputhje me atë që ka udhëzuar Kuvendi, kemi gjetur fonde, kemi arritur të realizojmë krijimin e një sistemi të ri për caktimin e ankesave në institucionin e Avokatit të Popullit, me ndihmën e OKB-së, por për këtë na duhet të kemi staf të brendshëm, pasi AKSHI nuk na *hoston*, pra na ka sjellë përgjigje negative që nuk e *hoston* databazën tonë. Për këtë arsye, duke pasur një databazë tonën, të mbajtur në institucion, do të na duhen edhe cilësitë e stafit që lidhet me informacionin dhe teknologjinë, që të jenë të një niveli tjetër.

Këto ishin kërkesat tona, të cilat, sigurisht që janë minimaliste. Nëse do të shkojmë te kërkesat maksimaliste, do të kishim të tjera, pasi ky është një institucion që nuk është rinovuar thellësisht asnjëherë, që nga momenti që ka ardhur në këto zyra, që janë më shumë se 20 vjet. Prandaj, do të ishte e nevojshme që të shihet mundësia për projekte të rëndësishme në lidhje me ndryshimin e infrastrukturës.

Faleminderit!

Klotilda Bushka – Faleminderit, zonja Ballanca!

Po, zoti Xhoxhi.

Klevis Xhoxhi – Faleminderit!

Faleminderit, zonja Ballanca, për prezantimin që bëtë për institucionin e Avokatit të Popullit!

Kolegë, që në fillim të fjalës sime më lejoni t’ju theksoj se buxheti i vitit 2024, ashtu si për të gjitha institucionet e tjera, edhe për Avokatin e Popullit është shtuar në krahasim me buxhetin e vitit 2023. Pra, rezulton një rritje e shpenzimeve totale prej rreth 40,2 milionë lekësh ose 29% më shumë nga buxheti i vitit 2023, sipas aktit normativ nr. 5, ku shpenzimet për paga janë rritur në masën 39, 7 milionë lekë ose 37% më shumë, shpenzimet për mallra ose shpenzime kanë rënë me 500 milionë lekë dhe shpenzimet për investime dhe transfertë kanë mbetur të pandryshuara.

Gjithashtu, numri i punonjësve për vitin 2024 është parashikuar të jetë 59 punonjës, pra është parashikuar i pandryshuar. Pra, kolegë buxheti total i parashikuar për vitin 2024 për

Avokatin e Popullit është diku 178,2 milionë lekë, nga të cilat 147,7 milionë lekë janë shpenzime për paga dhe sigurime shoqërore; 24, 1 milionë lekë janë shpenzime për mallra dhe shërbime; 2,4 milionë lekë është zëri i transfertës dhe 4 milionë lekë është zëri për shpenzime dhe investime.

Po të bëjmë krahasimin referuar të dhënave që ne disponojmë sa i përket 9-mujorit të parë të vitit 2023, rezulton se buxheti për Avokatin e Popullit është realizuar në masën 82%, nga të cilat shpenzime për pagën në masën 91%, shpenzime për mallra dhe shërbime në masën 41% dhe shpenzime për investime në masën 55%.

Zonja Ballanca i përmendi dy kërkesat që ka paraqitur institucione për shtesë në fondet e akorduara në projektbuxhet, pra në tavanin buxhetor, konkretisht në zërin për paga dhe shpenzime në vlerën 9,97 milionë lekë dhe në zërin për sigurime shoqërore në vlerën 816 milionë lekë. Zonja Ballanca në kërkesën që bëri për shtesë në strukturë në shtesën e një punonjësi si ndihmëskomisioner dhe përfshirjen e punonjësve me kontratë të përkohshme i shpjegoi arsyet dhe unë nuk dua të ndalem dhe t'i përsëris edhe një herë.

Të nderuar kolegë, kjo ishte një panoramë e shkurtër e projektbuxhetit të vitit 2024 për institucionin e Avokatit të Popullit dhe realizimin e buxhetit të vitit 2023.

Bashkë me sugjerimet tuaja dhe me diskutimet që do të bëjmë në komision, si dhe me vëmendjen e Ministrisë së Financave do të konkludojmë për t'ia paraqitur raportin tonë Komisionit të Ekonomisë.

Klotilda Bushka - Faleminderit!

Nga Ministria e Financave, zoti Gentian Opre.

Gentian Opre – Faleminderit!

Lidhur me nevojat shtesë, ne kemi një diferencë në databazën tonë me atë të Avokatit të Popullit. Kemi pasur diskutime lidhur me disa pozicione dhe vlerat përkatëse për këto pozicione. Gjithsesi, mbeten në diskrecionin e komisionit të nderuar që ta shikojë edhe këtë. Ne jemi në diskutime me Avokatin e Popullit për këtë qëllim. Pra, mbetet në vendimin e këtij komisioni shtesa që kërkohet në shpenzimet kapitale. Shumat janë relativisht minimale. Pra, kemi këtë diskrepancën për disa pozicione në përllogaritjen e pagave. Pra, ne kemi një databazë dhe përcaktime në këtë databazë dhe Avokati i Popullit ka përllogaritjet e veta. Pra, ka një debat, që vazhdon në këtë kontekst. Kështu që, nuk them dot më shumë se ta lë në vlerësimin e këtij komisioni për të bërë një vlerësim të tij dhe çfarë mund të akomodohet për këtë institucion.

Faleminderit!

Klotilda Bushka - Faleminderit, zoti Opre!

Shkresa me shkrim që ka ardhur nga Avokati i Popullit le t'u shpërndahet të gjithë anëtarëve të komisionit.

A ka pyetje?

Kam unë dy pyetje, zonja Ballanca.

Në treguesit financiarë për vitin 2024 sa i takon realizimit të buxhetit për 9 muajt e parë na rezulton deri në masën 55%, ndërkohë që ju thatë se e keni pothuajse 90 ose 90 e ca për qind, nëse nuk gaboj. Ju përfshini periudhën deri më sot, siç duket...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Një sekondë, të mbaroj me pyetjet dhe pastaj do t'jua jap fjalën.

Një sqarim më shumë për këtë.

Pyetja tjetër është në lidhje me shtesat. Me aq sa unë kuptoj, një nga nevojat që ju keni është teknike, pra për të rakorduar me ministrinë diferencat në paga për stafin aktual, nuk bëhet fjalë as për shtesa për numër, por bëhet fjalë, nëse është në operacionalitet të plotë e gjithë struktura dhe si realizohet ajo. Kjo është një çështje teknike, prandaj unë do t'i ftoja si përfaqësuesit e Ministrisë së Financave, edhe Avokatin e Popullit ta zgjedhin këtë çështje mes tyre kur të rakordojnë me relatorët para se Komisioni i Ligjeve të bëjë shqyrtimin nen për nen të buxhetit.

Për pjesën e ndihmëskomisionerit, do të doja të dija nga ju, sepse ju kërkonte të shtohet një ndihmëskomisioner, për cilin seksion? Do të doja të na e sqaronit më mirë edhe një herë, në mënyrë që kolegët ta kuptojnë se për cilin seksion ju e kërkonte dhe pse? Pse duhet ndihmëskomisioner? Pse ju me stafin që keni nuk i realizoni dot detyrat aktuale?

Ndonjëherë ne shtojmë e shtojmë struktura, ndërkohë që treguesit e performancës janë po njësoj. Unë nuk paragjykoj asgjë, por thjesht dua të kemi një planifikim eficient të shpenzimeve që kemi për stafin, ato që kemi për investimet dhe ato që na duhen për shpenzime të përgjithshme.

Sa punonjës me kontratë të përkohshme keni ju, të cilët synoni t'i ktheni në strukturë si punonjës të përhershëm? A lidhet kjo me raportin e fundit të Bashkimit Europian për performancës që u bëri institucioneve të barazisë në Shqipëri? A është kjo një kërkesë? Nëse është një kërkesë, ne do të donim të kishim konkretisht raportin me rekomandimet përkatëse, atë pjesë ku nënvizohet kjo çështje. Sepse, nëse kjo do të jetë një kërkesë në kuadër të vlerësimit që

na bën Bashkimi European për institucionet e pavarura, ne do të duhet ta fiksojmë këtë në raportin për komisionin tonë.

Zonja Ballanca, fjala për ju.

Zonja Ballanca, duhet të hapni mikrofonin.

Erinda Ballanca – Më falni!

Ju falënderoj!

Në fakt, pyetjet janë shumë specifike. Sa i takon realizimit, realizimi është progresiv, zë pas zëri. Realizimi i 9-mujorit, ne tani jemi në fund të 11-mujorit, shifrat kur ka ardhur projektbuxheti kanë pasur të bëjnë me realizimin deri në 9-mujorin e parë, dhe ka shpenzime që janë në vijimësi. Ne, kur flasim për realizim të pritshëm, bëjmë deklarin për realizimin e pritshëm. Për zërin e “pagave” dhe të “sigurimeve shoqërore” ky është 97,6%, pra e kemi pothuajse të realizuar zërin të tërë deri në fund të vitit, pasi nuk mund ta realizojmë 100% këtë masë deri në fund të shtatorit, duhet ta lëmë edhe për 3 muajt e tjerë që do të jenë në vijim.

I vetmi zë, i cili nuk është realizuar në mënyrë të plotë, siç jua thashë, është zëri që ka të bëjë me transfertat për përfundimin e marrëdhënieve të raportit. Ky është i vetmi zë që ne parashikojmë ta realizojmë deri në fund të vitit në masën 42%, nëse nuk ka vendimmarrje nga ana e Kuvendit në lidhje me përfundimin e mandateve, qoftë të komisionerëve dhe emërimin e ri, apo qoftë edhe të Avokatit të Popullit.

Zëri 602, është një zë që do të realizohet në masën 92,35% deri në përfundim të vitit, pasi ka disa shpenzime, të cilat kryhen në fund të vitit. Shpenzimi kryesor, siç edhe ju e dini, është ai i Konferencës Kombëtare që ne realizojmë si traditë në dhjetor të çdo viti.

Sa i përket realizimit total të buxhetit në fund të vitit, ne do ta kemi 96,64%. Aktualisht është 82% realizimi i buxhetit deri nga shifrat që ne kemi. Ne mund t’jua dërgojmë edhe të plotë realizimin, pasi nga financa sapo më thanë që deri në momentin që jemi duke folur realizimi është 82%.

Në lidhje me kërkesat që ne kemi bërë, në raportin e Bashkimit European për vlerësimin e institucionit të barazisë, në të cilin u vlerësua edhe institucioni i Avokatit të Popullit, disa kërkesa janë me karakter ndryshimesh ligjore, pra janë gjëra jothelbësore, por që ne i kemi pjesë të punës sonë. Ai që do të jetë një ndryshim thelbësor dhe i rëndësishëm, por që duhet vlerësuar nga ky komision se është çështje procesi, është zgjerimi i mandatit të Avokatit të Popullit në

sektorin privat. Ky do të jetë një ndryshim thelbësor i ligjit, i cili do të kërkojë vërtet më pas buxhet dhe staf të shtuar.

Në lidhje me buxhetin kërkesat thelbësore janë të vetmet ndryshime që ka bërë Bashkimi European. Në fakt, ata kërkojnë një buxhet dhe rritje thelbësore të stafit, pasi thonë se mandati nuk mund të realizohet me kaq staf sa ata kanë. Unë kam sjellë modelin e Portugalisë si një model për t'ju thënë sa janë stafet pak a shumë për të njëjtat mandate dhe për të njëjtën popullsi, por ne praktikisht kemi sot gjysmën e buxhetit që ata kanë.

Unë jam duke bërë referencën dhe raportin, të cilin sigurisht do t'ju dërgoj. Ato kërkesa, që unë mendoj se janë kërkesa që mund të realizohen, ku ne mund të kemi një realizim dhe paraqitje të thjeshtë përpara komisionit, janë pikërisht për përfshirjen e stafeve të zyrave rajonale dhe numrit prej 10 personash. Ne historikisht kemi pasur 7 persona me kontratë, vjet na u dhanë edhe 3 dhe sot aktualisht kemi 10 persona me kontratë. Këtu kërkesa është e vogël, sepse ata duhet të jenë në nivel specialisti, pra të themi se sforcoja që duhet të bëjë buxheti është e vogël, vetëm për ato 2 orët shtesë, pra nuk është ndonjë shtesë apo problem i rëndësishëm për buxhetin, kështu që mendoj se realizimi i kësaj kërkesë do të ishte më i mundshëm për t'u bërë me këtë buxhet, pasi ne kemi buxhet, ose shteti na paguan nëpërmjet kontratave të stafit për personat me kontratë për 6 orë, pra për këta individë, dhe një shtesë në buxhet për 2 orë.

Sa i përket numrit të stafit në të tërë sektorët ne kemi mangësi në staf. Ne kemi një buxhet dhe numër stafi, i cili adreson më së miri mandatin tonë të parë, parësor, atë të trajtimit të ankesave. Sa i përket mandatit tonë të promovimit të të drejtave të njeriut ai është një mandat, të cilin ne nuk e realizojmë dot në mënyrë thelbësore me numrin e stafit që kemi. Kjo gjë është përcaktuar edhe në vlerësimin e Bashkimit European.

Arsyeja pse ne kërkuam staf shtesë në mekanizmin kundër torturës është, siç edhe jua tregova, sepse nevoja që ka për të zhvilluar inspektime më të mëdha në këtë fushë do të shtohet gjatë vitit në vijim, duke shtuar pikërisht edhe shumë vende të tjera në të cilat personat janë të privuar nga liria, sepse mekanizmi bën inspektime parandaluese në ato institucione ku personat janë të privuar nga liria. Nuk janë vetëm burgjet, nuk janë vetëm komisariatet, por janë edhe shtëpitë e të moshuarve, jetimoret, si dhe çdo vend tjetër ku personat nuk ia dalin të jenë të lirë për të vepruar dhe ndërvepruar. Këtë ndryshim do ta bëjë marrëveshja e pritshme, e cila besoj se do të miratohet nga Kuvendi, ka ardhur për miratim në Kuvend, për pritjen e një numri të caktuar emigrantësh nga ana e Italisë. Në kuadër të bashkëpunimit ne kemi marrë kontakte me

homologun tonë në Itali dhe do të na duhet të vijojmë punën për të garantuar zbatimin e standardeve më të larta të të drejtave të njeriut edhe për këta persona.

Siç edhe ju e dini, ka pasur shumë diskutime në lidhje me këtë marrëveshje, pavarësisht se marrëveshja nuk ka kaluar ende në Kuvend, por ne do të na duhet të marrim masat, pasi buxhetet janë paraprake, për të pasur një trajtim sa më dinjitoz të këtyre personave brendapërbrenda strukturave, por sigurisht edhe për atë që do të jetë pjesë, nga sa kemi lexuar, e detyrave të shtetit shqiptar për të garantuar që e gjithë ruajtja dhe mbrojtja e këtyre strukturave duhet të jetë e bërë duke qendëruar dhe duke pasur në vëmendje të drejtat e njeriut.

Klotilda Bushka – Mirë, zonja Ballanca.

Erinda Ballanca – Sa i përket raportit dua t’ju them edhe diçka tjetër. Raporti që është paraqitur nga Bashkimi European ka ardhur nëpërmjet Ministrisë së Jashtme. Për të bërë komentet finale, nëse kishte ndonjë problematikë në lidhje me gjetjen, ne i kemi bërë komentet tona në lidhje me gjetjet e raportit dhe i kemi paraqitur ato në Ministrinë e Jashtme. Ne do t’ju paraqesim atë kopje të raportit që na ka ardhur nga Ministria e Jashtme.

Klotilda Bushka – Në rregull.

Faleminderit, zonja Ballanca!

Shoh se asnjë koleg nuk po e kërkon fjalën për diskutime.

Atëherë, në lidhje me institucionin e Avokatit të Popullit, unë gjykoj se saktësimet financiare që janë të natyrës teknike relatorët t’i rakordojnë me institucionin dhe Ministrinë e Financave. Sa u takon shtesave në strukturë për punonjësit që janë me kontratë të përkohshme, nëse bëhet fjalë edhe për punonjësit që janë nëpër rrethe, të shihet sistemi i tyre, ndoshta me kontratë të përhershme, ndoshta jo menjëherë, por të bëhet një planifikim sipas nevojave të institucionit. Po, institucioni mund të marrë në të ardhmen shumë detyra të tjera edhe në kuadër të ndryshime ligjore që kërkohen, por ne do ta planifikojmë duke pasur në konsideratë parimin “e prioritizimit” edhe të “domosdoshmërisë”, sigurisht edhe mundësitë buxhetore që ne kemi.

Ndaj, zonja Ballanca, ju si të gjithë përfaqësuesit e institucioneve të tjera, duhet të jeni në kontakt me relatorët dhe me Ministrinë e Financave për të rakorduar në lidhje me këto shpenzime. Ne si komision do t’ju mbështesim sa u takon funksioneve që institucionet të plotësohen me mbështetjen buxhetore dhe të jenë në gjendje t’i ushtrojnë detyrat e veta në përputhje me ligjin, të pandaluar nga mjetet financiare apo stafet e nevojshme, por do të na duhet që edhe ne të ecim me parimin e eficiencës së planifikimit të shpenzimeve, sepse nuk do të

donim që për asnjë institucion të miratonim shpenzime që nuk realizohet brenda vitit, ndërkohë që ky fond digjet dhe mund të përdorej për një investim tjetër.

Gjithsesi, ne e vlerësojmë prezantimin që ju bëtë sa u takon nevojave të institucionit. Relatorët të rakordojnë dhe të jeni gati me informacionin para se të shqyrtohet projektbuxheti nën për nën në komision.

Zonja Ballanca, faleminderit!

Erinda Ballanca – Faleminderit juve!

Klotilda Bushka - Së bashku me stafin që ju shoqëron jeni e lirë të largoheni.

Ne do të vijojmë me dëgjesën tjetër. Ministria e Shtetit për Pushtetin Vendor është e përfaqësuar nga ministri, zoti Arbi Mazniku.

Mirë se erdhët, zoti Nazniku, në mbledhjen *online*!

Gjithashtu, janë prezentë për Shoqatën e Autonomisë Vendore, kryetari i Bashkisë Pogradec, ish-kolegu, Ilir Xhakolli.

Ilir, mirë se erdhe!

Kryetari Bashkisë së Elbasanit, zoti Gledian Llatja, kryetarja e Bashkisë së Dimalit, zonja Juliana Memaj, nënkryetari i Bashkisë së Tiranës, zoti Andi Seferi dhe drejtorja Ekzekutive e Shoqatës, zonja Adelina Farriçi.

A është zonja Farriçi? Po.

Mirë se erdhët!

Nga shoqata e Këshillave të Qarqeve të Shqipërisë është zonja Alma Selami, kryetare e qarkut Dibër. Nga Ministria e Financave, përveç zotit Gentian Opre është edhe zoti Fran Brahim, drejtor i Drejtorisë së Financave Vendore, Drejtorja e Përgjithshme e Buxhetit. Frani, e njeh financën e pushtetit vendor më mirë se kushdo tjetër.

Zoti Mazniku, fjalën do t'jua kaloj ju për një prezantim tuajin në lidhje me nevojat që ka pushteti vendor dhe sa adresohen ato në projektbuxhetin e vitit 2024, si dhe çfarë keni ju të rëndësishme për ta ndarë me këtë komision, që ne t'i diskutojmë dhe ta bëjmë pjesë atë që ju keni domosdoshmëri në raportin tonë për komisionin përgjegjës.

Arbi Mazniku – Përshëndetje!

E nderuar zonja kryetare,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar pjesëmarrës të tjerë,

Shumë faleminderit për ftesën!

Është kënaqësi për mua ta bëjmë këtë diskutim së bashku për një nga dokumentet më të rëndësishëm që kalon vendi dhe Parlamenti, sigurisht, buxheti i vitit 2024. Buxheti i vitit 2024 ka një seri elementesh shumë të rëndësishme sa i përket pushtetit vendor. Duke pasur parasysh që buxheti në tërësi ka një rritje prej 4,2 apo 4,3% në vlerën nominale, krahasuar me 1 vit më parë, buxheti vendor është rritur me 10,3%, çka është tregues i qartë i faktit se për qeverinë shqiptare pushteti vendor është trajtuar me prioritet, duke marrë një pjesë më të madhe sesa rritja tërësore e buxhetit.

Sigurisht, hallet e pushtetit vendor janë të mëdha dhe mbështetja financiare nuk është asnjëherë e mjaftueshme, por thelbi është se i është dhënë pushtetit vendor një prioritet në raport me një pjesë të madhe të vendit, duke e rritur transfertën në tërësi me pothuajse 2 herë e gjysmë më shumë sesa është rritja tërësore e buxhetit.

Pra, sa u takon numrave, buxheti vendor është rritur me 10,4% krahasuar me vitin 2023, transfertat e kushtëzuar për bashkitë është 35 miliardë nga 30 miliardë që ishte në vitin 2023, pra kemi një rritje të kësaj transferte me 16,7% krahasuar me 1 vit më parë. Bashkitë kanë pasur rritje të transfertës midis 14 dhe 20%, duke iu përmbajtur edhe formulës, të cilën mund t'juja detajoj më gjatë. Unë e di që ky debat bëhet çdo vit ndërmjet ministrive për formulën, por pa dyshim këtë diskutim më në detaje do t'juja bëjë zoti Brahimi.

Sidoqoftë, transfertat është ndërmjet 14 dhe 20% për të gjitha bashkitë. Rritja e nivelit të pagave është parashikuar ta fillojë zbatimin në nivel vendor, pasi transfertat e kushtëzuar parashikon gati 1,5 miliardë vetëm për këtë zë. Transfertat e pakushtëzuar **servejal është rritur me 11,3 miliardë në vitin 2023 nga 13,7 miliardë lekë për vitin 2024**, ndërkohë që rritja e transfertës sektoriale është 23%. Transfertat e pakushtëzuar e përgjithshme po ashtu është rritur **me 19,5 miliardë lekë, nga 19,5 miliardë që ishte në vitin 2023 në 22 mijë lekë për vitin 2024**, rritja edhe këtu është 13% krahasuar me vitin e mëparshëm.

Gjithashtu, parashikimet janë që edhe të ardhurat vendore, të ardhurat e veta dhe taksat e ndara të kenë rritje. Të ardhurat e bashkive nga taksat e ndara do të rriten me rreth 1,4 miliardë lekë për vitin 2024 krahasuar me vitin 2015, kur ka filluar koncepti i taksave të ndara. Në vitin 2024 taksa e pasurisë llogaritet që të mblidhet në vlerën 5,7 miliardë lekë ose rreth 1,8 miliardë më shumë krahasuar me vitin 2015, sërish si rrjedhojë e reformave që janë bërë në strukturë dhe në mënyrën e mbledhjes së taksës së pronës.

Gjatë vitit 2024 synohet që nëpërmjet rritjes së shpenzimeve të bëhet i mundur plotësimi sa më mirë i shërbimeve ndaj qytetarëve dhe rritja sa më mirë e prioriteteve të lidhura me pushtetin vendor. Për këtë qëllim pesha specifike e shpenzimeve të buxhetit vendor ndaj buxhetit të shtetit është rritur ndjeshëm. Në vitin 2024 do të jetë 9,6%, krahasuar me vitin 2015, ku shpenzimet e buxhetit vendor zinin rreth 7,79% të shpenzimeve të buxhetit të shtetit. Kjo në thelb, në krahasim me tërësinë dhe me rregullat që ka vendi, besoj se është përqsje e kënaqshme, por duhet të kemi parasysh që gjendemi përpara një viti shumë të rëndësishëm, i cili do të ndikohet nga të paktën 3 elemente.

Së pari, vitin e ardhshëm do të kemi të dhënat e reja të censit, i cili do të ndikojë sistematikisht në mënyrën e ndarjes dhe në formulën për të cilën eventualisht, në momentin që do të kemi të dhënat, do të duhet të bëjmë një diskutim publik së bashku me bashkitë, për të kuptuar se çfarë ndikimi do të kenë të dhënat si në të ardhurat e veta, si në shpërndarjen e financimeve.

Gjithashtu do të unifikojmë procedurat buxhetore të të gjitha bashkive, të cilat do të mundësojnë futjen e konceptit të performancës në shpërndarjen e të ardhurave. Pra, gjatë vitit të ardhshëm, pavarësisht se ne e kemi ligj, do ta diskutojmë në mënyrë thelbësore, si pjesë të mekanizmit të shpërndarjes së financimeve qeveritare, edhe performancën e bashkive, si element ekstra në formulë.

Po ashtu, meqenëse vitin që vjen mbushen 10 vjet nga reforma administrative, dua ta ridiskutojmë, sepse mendojmë që viti 2024 është momenti i duhur për të bërë një analizë tërësore të mënyrës së financimit të pushtetit vendor, por edhe të **konkurrencave** që pushteti vendor ka, në mënyrë që të gjejmë balancën e duhur midis mundësisë së bashkive për të dhënë shërbime dhe nevojës për mbështetje buxhetore nga ana e qeverisë.

Faleminderit!

Klotilda Bushka – Faleminderit, zoti Mazniku!

E kërkon dikush fjalën nga shoqatat prezente? Ndoshta, zonja Farriçi?

Atëherë, a të fillojmë me kryetarët e bashkive? Duhet të dilni në kamera dhe të ngrini dorën, sepse në të kundërt unë nuk ju kuptoj.

Atëherë, fjalën e kanë kërkuar zoti Ilir Xhakolli, zoti Gledian Llatja, zonja Juliana Memaj, zonja Eriselda Sefa . Fjalën po ia jap një zonje dhe po fillojmë me zonjën Juliana

Memaj. Më pas do të vazhdojmë me zotin Xhakolli, me zonjën Eriselda Sefa dhe zotin Gledian Llatja.

Zonja Memaj, fjala është për ju. Hapeni mikrofonin, zonja Memaj! Teknika të mundësojë audion e zonjës Juliana Memaj. Zonja Memaj nuk dëgjoheni, duhet të hapni audion në kompjuterin tuaj.

Atëherë, deri sa zonja Memaj të rregullojë këtë defekt teknik, po ia kaloj fjalën zonjës Eriselda Sefa dhe më pas do t'ia jap menjëherë fjalën. Zonja Sefa, duhet të hapni audion. Teknika të mundësojë audion për zonjën Eriselda Sefa.

Eriselda Sefa – Përshëndetje, të gjithëve!

Shumë faleminderit që na jepni mundësinë edhe neve, kryetarëve të bashkive, të lidhemi drejtpërdrejt me qytetarët! Në fakt, dua të falënderoj Ministrinë e Financave dhe qeverinë që na kanë bërë një rritje granti në krahasim me vitin 2023.

Në emër edhe të 5 kryetarëve të tjerë të qarkut të Fierit, unë do të ngre vetëm 2 nga pikat, në mënyrë që edhe kolegët e tjerë të mund të flasim.

E para ka lidhje me programet buxhetore që neve na kanë kaluar si pushtet vendor. Disa qarqe kanë përfituar nga programi i menaxhimit të mbetjeve, duke qenë se janë qarqe që kanë filluar t'i çojnë mbetjet e tyre drejt *landfill*-eve apo inceneratorëve. Ndërkohë, qarku i Fierit e ka filluar depozitimin e mbetjeve në incenerator qysh nga viti 2021 dhe të gjashtë kryetarët e bashkive kanë bërë kërkesë që në vitin 2022, por edhe tani në vitin 2023, në mënyrë që në këtë program të futeshin edhe bashkitë, sepse na është rritur kostoja e transportit drejt inceneratorit të Fierit dhe ne paguajmë edhe 1400 lekë për ton për mbetjet që ne depozitojmë atje. Kështu që, do të doja të merrej parasysh të vendosej një grant edhe për qarkun e Fierit, në mënyrë që të mos e kishim zero lekë, por të përfshiheshim si qarqet e tjera, ai i Elbasanit, i Gjirokastrës, i Durrësit, i Tiranës dhe i Lezhës.

Lidhur me problematikën tjetër, duke qenë se qarku i Fierit është edhe zemra e bujqësisë dhe zonat tona janë kryesisht zona rurale, do të propozoja, nëse është mundësia, shtimin e fondeve për programin e rrugëve rurale. Patjetër që ne duhet t'u shërbejmë banorëve tanë të këtyre zonave rurale me mirëmbajtjen e rrugëve, por edhe me shtrimin e rrugëve të reja, në mënyrë që ata të kenë mundësinë të punojnë tokat e tyre, të nxjerrin prodhimin, por edhe të marrin shërbimin nga institucionet përkatëse. Kështu që, shpresoj të merren parasysh. Për vitin 2024 institucionit tim, për shembull, i janë miratuar vetëm 9 milionë lekë në programin e rrugëve

rurale, e cila është një shumë mjaft e vogël për t'u shërbyer 86 fshatrave që unë kam në administrim.

Shumë faleminderit, duke shpresuar të na mbështeten këto 2 propozime!

Klotilda Bushka – Faleminderit, zonja Sefa, që ishit koncize dhe e fokusuar!

Nuk e di nëse zonja Memaj është gati.

Zonja Memaj, nga teknika më thonë që keni probleme me mikrofonin e kompjuterit tuaj. Do t'ia jap fjalën zotit Xhakolli. Zonja Memaj, nga teknika më thonë që duhet të dilni dhe të hyni përsëri, pra të dilni nga mbledhja dhe të bëni prapë *log in*.

Zoti Xhakolli, fjala është për ju.

Ilir Xhakolli – Faleminderit shumë që na bëni pjesë në një komision kaq të nderuar, siç është Komisioni i Ligjeve!

Në fakt, janë 3 shqetësime të cilat unë ia kam përcjellë edhe ministrit në turin që ai ka ndërmarrë në bashkitë e vendit. Unë nuk e di, por ndoshta edhe Ministria mund t'jua ketë përcjellë me shkrim.

Shqetësimi i parë ka të bëjë me heqjen e fashës së nivelit të pagave. Besoj se këtë shqetësim e kanë të gjithë kolegët. Kemi një fashë në nivelin e pagave nga zero deri në 50 mijë banorë, nga 50 mijë deri në 100 mijë banorë e me radhë. Pra, ne nuk e kemi këtë luks në Pogradec që, për shembull, të gjejmë një arkitekt, një inxhinier ndërtimi apo një manovrator, i cili të paguhet me 400 mijë lekë. Pra, duam mbështetjen tuaj që kjo të sistemohet, pra të lihet e lirë për pushtetin vendor.

Për shqetësimin e dytë besoj se jemi në vendin e duhur për t'u shprehur. Kur u bë reforma territoriale çdo bashkie i është dhënë një... *(nuk dëgjohet)*. Në rastin e Pogradecit, nuk e di për bashkitë e tjera, e gjithë sipërfaqja e territorit është rreth 72 mijë hektarë dhe nga këto më shumë se gjysmën e kanë zonat e mbrojtura. Ne jemi dakord të konsultohemi me zonat e mbrojtura, por me një VKM të vitit 2020, nëse nuk gaboju, dhe me një të vitit 2022, e kanë hedhur poshtë ligjin. Pra, zonat e mbrojtura, jo vetëm... *(nuk dëgjohet)*

Klotilda Bushka – Zoti Xhakolli, u ndërpre linja.

(nuk dëgjohet)

Zoti Xhakolli!

Ilir Xhakolli – *(nuk dëgjohet)* ...më duket në kundërshtim me ligjin, pra hedhin poshtë ligjin, që ka kaluar edhe me vendim kur u bë reforma territoriale. Kjo neve na ndihmon shumë

dhe ky është shqetësim i drejtë nga ana jonë, sa i takon borxhit publik të trashëguar. Vetëm nga ky veprim, të na lejohet neve ta marrim qiranë. Patjetër na duhet bashkëpunimi me zonat e mbrojtura, por qiranë e tokës duhet ta marrë bashkia, sepse ajo është pronare dhe kështu ne mund të lajmë borxhet e trashëguara, pasi kemi 4 vjet që po mundohemi dhe nuk po ia dalim dot. Në fakt, në të gjitha takimet që kemi bërë me Ministrinë e Financave gjithmonë na thuhet se duhet t'i lajmë borxhet dhe unë kam përgjegjësi për veprime të cilat nuk i kam kryer unë, sepse ato janë të trashëguara dhe nuk kam as mundësinë për t'i shlyer. Ndërkohë, unë nuk mund të vazhdoj dot më kështu. Nga zona e kuqe ku ishim kemi kaluar në zonën portokalli, por përsëri unë shoh se me mundësitë që ka kjo bashki, ajo nuk do të mund ta shlyejë këtë detyrim, prandaj kërkojmë edhe mbështetjen tuaj. Në fakt, ne jemi njerëz në politikë dhe unë jam votuar jo për të larë borxhet, por për ta bërë këtë bashki. Kjo nuk ka shanse të ndodhë, që të hiqen të gjitha shërbimet dhe të lahen borxhet.

Këto doja të ndaja me ju dhe unë kam besim të plotë që diçka nga këto do të merret në konsideratë nga Komisioni i Ligjeve.

Klotilda Bushka – Zoti Xhakolli, faleminderit!

Në kohën kur po flisnit, u ndërpre pak interneti dhe nuk e kuptuam drejt papajtueshmërinë e VKM-së me ligjin, sa u takon zonave të mbrojtura. A mund ta përsërisni edhe një herë?

Ilir Xhakolli – Për zonat e mbrojtura, edhe me Kushtetutë, çdo bashki ka një territor të caktuar, që ia keni dhënë me ligj. Pra, unë kam 72 mijë hektarë, në fakt 40 mijë hektarë nga këto i kanë marrë zonat e mbrojtura në Pogradec dhe i administrojnë ata. Edhe japin licenca për zhvillime minerare apo turistike, por edhe qiranë e tokës e marrin ata, ndërkohë që pronar i tokës është Bashkia. Vetëm me qiratë e tokës, që sot i marrin ata, unë mund të shlyeja borxhet, detyrimet e prapambetura që ka trashëguar kjo Bashki. Ky është thelbi i këtij problemi. Unë e kam diskutuar vazhdimisht, kam 2-3 vjet që e ngre këtë problem, por nuk po gjej mundësi për ta zgjidhur.

Ndërkohë nuk e di a u dëgjua pjesa e heqjes së fashës.

Klotilda Bushka – Po.

Ilir Xhakolli – Këtë e kërkojnë të gjithë kolegët, sepse nëpër bashkitë tona, që janë bashki të vogla, nuk mund të gjesh dot as një manovrator, të cilit mund t'i japësh 400 mijë lekë,

pasi bizneset japin nga 1 milion apo nga 2 milionë. Pra, mendoj se duhet lënë dorë e lirë për nivelin e pagave.

Këto ishin shqetësimet e mia.

Klotilda Bushka – Faleminderit, zoti Ilir!

Atëherë, fjalën e ka zoti Llatja, kryetari i Bashkisë së Elbasanit.

Gledian Llatja – Përshëndetje!

Faleminderit që na bëni pjesë të këtyre diskutimeve, për të ndarë edhe problematikat të cilat ne i shohim si të domosdoshme!

Ne kemi pasur takime të vazhdueshme edhe me Këshillin Konsultativ, me përfaqësues të ministrive, por më vjen mirë që jemi edhe bashkë për të diskutuar pikërisht për buxhetin e vitit 2024. Në fakt, është e vërtetë dhe neve na bëhet qejfi që për herë të parë arritëm 1% të GDP-së, kjo për shkak edhe të rritjes që pati vetë ekonomia gjatë kësaj periudhe. A është e mjaftueshme? Nuk është e mjaftueshme. Besoj se me të gjithë kryetarët e bashkive jemi dakord që është pak të vijë 1% e GDP-së për pushtetin vendor, nuk është e mjaftueshme krahasuar me të gjitha vendet e rajonit. Patjetër, është një kërkesë e vazhdueshme jona rritja e granteve specifike, rritja e mbështetjes nga qeveria qendrore, sidomos për funksionet e deleguara.

Pra, nëse flasim për funksionet e deleguara, e kemi fjalën për një sërë funksionesh që na kanë kaluar nga qeverisja qendrore, edhe për shkak të decentralizimit. Tashmë po na zë frika të vazhdojmë të flasim për decentralizim, kur shohim të dhënat financiare që ne mbulojmë nga shpenzimet për të gjitha funksionet e deleguara që kemi realisht, të cilat janë shumta.

Dua të marr si shembull vetëm Bashkinë e Elbasanit. Për mbrojtjen sociale ne mbështesim 62% të buxhetit; për administrimin e pyjeve 87%, nga të ardhurat e Bashkisë dhe jo nga grantet specifike të qeverisë; për rrugët rurale 70% të buxhetit që ne harxhojmë e marrim nga të ardhurat e tjera të qytetarëve, dhe të gjitha këto janë kur vijnë grante specifike; 68% për ujitjen dhe kullimin e mbulojmë ne nga të ardhura të tjera në Bashkinë e Elbasanit; po ashtu menaxhimi i mbetjeve është 76%. Kur flasim për funksione të tjera të deleguara, siç është mbrojtja nga zjarri, ne jemi përpjekur ta mbajmë në të njëjtin nivel, pra të mos rrisim numrin e zjarrfikësve dhe të mbajmë të njëjtin nivel të shpenzimeve, por kemi një problem të madh kur flasim për këtë, sepse një flotë mjetesh, sidomos zjarrfikëse, ka konsumin e saj dhe duhet të rinovohet. Grantet specifike asnjëherë nuk vijnë me mbështetje specifike për blerjen e mjeteve apo funksionet e

deleguara nuk vijnë bashkë me rikonstrukcionet e ambienteve, ashtu siç kemi pasur për kopshtet dhe çerdhet, dhe përsëri kemi një buxhet të shtuar për mirëmbajtjen e tyre.

Ajo që kërkojmë në vazhdimësi është mbështetja financiare. Unë i jap shumë të drejtë edhe kryetares së Bashkisë së Lushnjës që kërkohen grante sidomos për trajtimin e mbetjeve, sidomos për mirëmbajtjen e rrugëve rurale, por edhe kryetarit të Bashkisë së Pogradecit, zotit Xhakolli, kur thotë se një pjesë e të ardhurave, që neve na takojnë si bashki, patjetër duhet të vijnë në pushtetin vendor drejtpërdrejt te qytetarët, për t'u përkthyer në investime të drejtpërdrejta për infrastrukturë apo në zgjidhjen dhe përmirësimin e cilësisë së jetesës së qytetarëve.

Unë jam i bindur që çdo institucion shtetëror në Tiranë, çdo institucion shtetëror në Elbasan, i cili ka detyrat e tij funksionale, ka marrë një rritje të të ardhurave të tij, të grantit, por ne po shohim vetëm një rritje shumë të vogël 10% apo 12%. Në disa raste ka arritur 11% rritja e grantit në Bashkinë e Elbasanit, ndërkohë vetëm rritja e rrogave që kemi pasur gjatë kësaj periudhe nuk i mbulon të gjitha shpenzimet që kemi. Patjetër kërkojmë një vëmendje më të shtuar, sidomos te grantet specifike, kërkojmë një vëmendje më të shtuar për të mbuluar ndoshta edhe ne këto problematika që kemi te kostot tona, sidomos te funksionet e deleguara, të cilat kanë ardhur si pasojë e decentralizimit në pushtetin lokal. Ne jemi për vazhdimësinë e decentralizimit, i cili në fakt ka 4 vjet që është pezulluar, por patjetër funksionet duhet të vijnë bashkë me financat dhe ky është momenti të vëmë një balancë, duke qenë se jemi edhe në Komisionin e Ligjeve, që funksionet e deleguara duhet të delegohen bashkë me financat. Nëse bashkive do të vazhdojnë t'u çojnë vetëm halle dhe nuk do t'u çojnë financa, do të cedojmë ne te shërbimet tona.

Ne kemi edhe një problem tjetër, sepse ne e shohim gjënë në tërësi. Pagat rriten, të gjitha rriten, por tarifat tona ne nuk i kemi me përqindje, por fikse. Nëse flasim për tarifën e ndriçimit, për tarifën e pastrimit, për tarifën e mirëmbajtjes së rrugëve rurale, të cilën ne të paktën e kemi në Elbasan, nuk i kemi me përqindje të ekonomisë, siç mund të jetë TVSH-ja që merr qeverisja qendrore, por i kemi me tarifa fikse, të cilat duhet t'i rrisim që të përshtatemi me rritjen ekonomike. Që të përshtatemi, duhet t'i rrisim me dhjetëra e dhjetëra për qind. Nuk është logjike për ne të rrisim tarifat me 50%, me 100% apo me 200%, kështu që kërkohet një mbështetje më e madhe edhe nga buxheti i shtetit, edhe nga qeverisja qendrore, duke qenë se i gjithë mekanizmi

ekonomik funksionon edhe në bazë të përqindjes së rritjes ekonomike të mbledhjes së të ardhurave.

Nuk dua të zgjatem më shumë.

Faleminderit, zonja Kryetare, për mundësinë që na dhatë për të bashkëbiseduar, por edhe për të kërkuar atë që ne mendojmë. Është e drejta jonë që të kërkojmë rritjen e gradave specifike, sidomos sa i përket mirëmbajtjes së rrugëve, menaxhimit të mbetjeve, administrimit të pyjeve. Një vëmendje të vazhdueshme ministritë përkatëse duhet t'i kushtojnë pajisjes me mjete specifike për ato shërbime që na kanë deleguar ne, si pushtet vendor, në të kaluarën. Faleminderit!

Klotilda Bushka – Faleminderit, zoti Llatja!

Fjala për zonjën Farriçi.

Adelina Farriçi – Përshëndetje!

E nderuar zonja kryetare e komisionit,

Unë ju falënderoj për ftesën që na dërguat lidhur me këtë dëgjese për buxhetin e financave vendore, që është një nga dëgjesat më kryesore! E mbështes fjalën e të gjithë kryetarëve parafolës, por dua të flas edhe në emër të të gjitha bashkive të tjera, duke përfaqësuar edhe bashkitë e vogla dhe të mesme, pavarësisht se përpjekja juaj maksimale ishte përfaqësimi i të gjitha bashkive.

Vlen të përgëzohet fakti që buxheti ka një rritje me 10,4% në përgjithësi dhe po ta ndajmë në transfertën e pakushtëzuar me 12%, më pas secila prej transfertave specifike ka një rritje. Ky patjetër është një sinjal pozitiv për pushtetin vendor. Nëse do t'i futemi që ta shikojmë zë për zë, ashtu siç tha edhe ministri, problematikat e pushtetit vendor janë kaq të mëdha, sa që edhe kjo rritje shihet jo e plotë nga ana e pushtetit vendor.

Po do të bëjmë një analizë nëse rritja e buxhetit të pushtetit lokal është përlllogaritur duke parë standardet dhe nevojat që ka pushteti lokal kundrejt plotësimit të standardeve të shërbimeve që ka ky pushtet, realisht, siç e thanë edhe kryetarët e bashkive, ky buxhet për pushtetin vendor nuk është i mjaftueshëm për realizimin e nevojave dhe realizimin e shërbimeve me standardet e kërkuara.

Nëse do t'u futemi këtyre transfertave specifike, për shembull, po të marrim transfertën e arsimit parashkollor, që është rritur me 9%, dhe po të bëhet një përlllogaritje, këtu ka ndryshuar standardi i edukatorëve, **nga 18 mijë për një edukatore, ka shkuar në 15 mijë**, këtu

automatikisht do të ketë një rritje shtesë të edukatorëve, dhe kjo rritje buxheti shkon pikërisht për pagat. Mirëpo, ky standard kërkon fonde shtesë edhe për investime. Këtu ne nuk shohim që kjo rritje mbulon edhe pjesën e investimeve, pasi zvogëlimi i numrit të fëmijëve në klasa do të çojë në rritje të numrit të klasave dhe automatikisht nga pushteti lokal kërkohen investime. Duhet të ketë një balancim, që standardi i kërkuar të plotësohet përkatësisht me koston për plotësimin e këtij standardi.

Paralelisht, po t'i shikosh të gjitha transfertat, edhe tek transfertat për administrimin e pyjeve, që rritet me 9%, buxheti i vitit 2024 ka financuar vetëm rritjen e pagave për administrimin e pyjeve. Ndërkohë, ne kemi shumë elemente për pyjet, ku një ndër to është bërja e planeve të mbarështimit, si dhe shumë elemente të tjerë që kërkohen. Kjo e detyron pushtetin lokal që nga të ardhurat e tij të vendosë fonde për këtë funksion, i cili është një funksion i transferuar si rezultat i decentralizimit pas reformës administrative-territoriale.

Një tjetër element dhe një shqetësim që ka qenë i vazhdueshëm nga ana e të gjitha bashkive, shqetësim që e ngriti edhe kryetarja e Bashkisë së Lushnjës, lidhet me rrugët rurale. Fondet e kaluara për mirëmbajtjen e rrugëve rurale janë të pamjaftueshme për pushtetin lokal, ndaj edhe kjo rritje është e pamjaftueshme për pushtetin lokal.

Një element tjetër që dua të përmend është ujitja dhe kullimi, që është rritur me 4,4%. Kjo rritje është vetëm për nivelin e pagave dhe nuk është në funksion të investimeve në këto fusha.

Ne si shoqatë i kemi sjellë rekomandimet tona pranë komisionit, por krahas rekomandimeve kemi sjellë edhe një propozim, që shoqata e ka bërë para 2 vjetësh, të cilin ia kemi propozuar edhe Ministrisë së Financave. Është një kërkesë e vazhdueshme, e cila është përfshirë edhe te strategjia e decentralizimit, rritja e përqindjes së rentës minerare, që kalon te pushteti lokal. Ne kemi kërkuar që kjo rentë të rritet nga 5% në 25% dhe mendojmë se për buxhetin qendror nuk është një shumë e konsiderueshme, ndërkohë që për pushtetin lokal është një shumë e konsiderueshme, e cila do të shkojë për zbutjen e problemeve sociale që kemi në këto vende, që kanë një masë të konsiderueshme të rentës minerare.

Do të doja të sillja në vëmendjen tuaj edhe një element tjetër, nivelin e pagave në pushtetin lokal, i cili vazhdon të mbetet në nivel diskriminues në krahasim me nivelin e pagave të institucioneve buxhetore. Ne e kemi kërkuar këtë në vazhdimësi, kemi pasur një takim edhe me ish-ministren e Financave, zonjën Ibrahimaj, ku na është premtuar se do të ketë një rishikim

tjetër të nivelit të pagave të pushtetit lokal me një VKM tjetër. Nëse do të ishte në vëmendje ky lloj rishikimi, që është domosdoshmëri dhe është kërkuar nga pushteti lokal, do të donim të ishte e paraparë edhe në buxhetin e vitit 2024, pasi ndryshimi i nivelit të pagave nuk mund të mbulohet nga të ardhurat e vetë bashkive, por duhet të rishihet patjetër edhe te buxheti i vitit 2024. Faleminderit!

Klotilda Bushka – Faleminderit, zonja Farriçi!

Janë shumë të rëndësishme ato që thoni, sepse ju përfaqësoni zërin e të gjithë anëtarëve të shoqatës, që janë një pjesë e madhe, ndoshta të gjitha bashkitë, dhe ne na duhet t’i shohim një për një. Jo të gjitha janë çështje të buxhetit, por janë çështje që ky komision i ka në fushën e përgjegjësisë së vet dhe ne do t’i prekim këto çështje një nga një.

Zonja Mema, jeni në linjë me audio? Nëse nuk mundeni, sillini sot me shkrim ato që keni për të thënë.

Zonja Mema, na vjen keq!

Zoti Andi Seferi, nënkryetar i Bashkisë së Tiranës, fjala për ju.

Andi Seferi – Përshëndetje, zonja kryetare!

Përshëndetje të gjithëve!

Është shumë i rëndësishëm diskutimi i këtij dokumenti, ashtu siç u tha edhe nga ministri, por edhe nga kolegët parafolës. Për të mos përsëritur gjërat, që ndoshta për bashkitë e tjera janë shumë më jetike, unë do të doja të nënvizoja që, krahas transfertave të pakushtëzuara sektoriale, të cilat për disa çështje, ku qeveria qendrore transferoi disa funksione të rëndësishme pranë njësisë, u transferuan vetëm fondet, por nuk u konsideruan standardet. Unë do të nënvizoja që të ketë një vëmendje të shtuar për sa u përket pyjeve dhe zjarrfikëseve.

Nga ana tjetër, ne si bashki kemi nënvizuar dhe kemi kërkuar që TAP-i të ndahet sipas bashkive. Duke qenë se ligji parashikon që shpërndarja e TAP-it të mblidhet për çdo bashki, Ministria e Financave duhet të gjejë mënyrën dhe mekanizmat që këtë gjë ta shpërndajë sipas ligjit. Pra, bashkitë duhet të marrin aq sa TAP-i kontribuon për qytetin, jo aq sa kanë numrin e popullsisë.

Gjithsesi, duke e kthyer vëmendjen në të dhënat që do të përftohen nga censi, besoj se kjo do të jetë edhe një formë për të ridimensionuar dhe për ta pasur akoma më shumë në konsideratë këtë gjë.

Do t'i falënderoj kolegët për të gjitha ndërhyrjet që bënë, sepse realisht qeveria vendore është ajo që përballet me qytetarin dhe kërkon të përditësojë sfidat e herëpashershme. Faleminderit!

Klotilda Bushka – Faleminderit, zoti Seferi!

Zonja Selami, fjala për ju.

Alma Selami – Faleminderit, e nderuar kryetare!

Të nderuar anëtarë,

Ju falënderoj për mundësinë që na dhatë për t'u shprehur në këtë komision të nderuar!

Ne, si Shoqatë e Këshillave të Qarqeve, duam të diskutojmë në lidhje me mosfunksionimin e Inspektoratit të Mbrojtjes së Tokës në këshillat e qarqeve. Në zbatim të kufizimeve të vendosura në ligjin nr. 160/2014 “Për buxhetin e vitit 2015”, neni 15 theksonte se këshillat e qarqeve përdorin deri në 15% të transfertës së pakushtëzuar për koston e personelit administrativ. Institucionet e këshillave të qarqeve të Shqipërisë në fund të vitit 2014, për shkak të ristrukturimit të administratës, e reduktuan këtë strukturë në masën 75% krahasuar me një vit më parë. Si rezultat i këtij ristrukturimi Inspektorati i Mbrojtjes së Tokës nuk u përfshi në strukturën organizative të administratës së këshillave të qarqeve për vitin 2015, duke vazhduar kështu me mungesën e kësaj strukture për shkak të kushtëzimit tjetër të vendosur në ligjin “Për buxhetin e vitit 2016” e deri më sot, ku theksohet: “Numri i personelit administrativ të këshillit të qarkut nuk mund të jetë më shumë se 10”. Në kushtet kur numri i personelit është taksativ 10 persona, numër që vështirëson kryerjen e detyrave dhe funksioneve të institucionit, është i pamundur krijimi i pozicionit të IMT-së, ashtu siç përcakton ligji nr. 8752, datë 26. 03.2001 “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”, i ndryshuar në ligjin nr. 9244, datë 17.06.2004 “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”, i ndryshuar”, si dhe VKM-ja nr.80, datë 28.01.2005 “Për përbërjen, mënyrat e funksionimit, detyrat dhe përgjegjësitë e strukturave të mbrojtjes së tokës bujqësore”.

Duke pasur parasysh gjithë praktikën e zhvilluar ndër vite me institucionin e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, si dhe interesin për pasjen e kësaj strukture, me qëllim parandalimin e dëmtimit të tokës bujqësore, konstatimit të rasteve të dëmtimit dhe vënien para përgjegjësisë së shkaktarëve, detyrime këto ligjore, kemi propozuar forma zgjidhjeje, por pa rezultat për të vazhduar kjo strukturë, qoftë edhe e reduktuar.

Ky problem madhor, për të cilin gjithmonë institucioni ka kërkuar mbështetje dhe zgjidhje nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, duhet të shihet me përparësi për të kërkuar ndryshime në ligj apo reformim të strukturave të administrimit dhe mbrojtjes së tokave, ku të shikohet edhe mundësia e përfshirjes së strukturave të IMT-së, pasi është problemi i të gjithë këshillave të qarqeve, në fakt, ku disa ligje, konkretisht ligji nr. 8752, datë 26.3.2001, i ndryshuar; ligji nr. 9244, datë 17.6.2004, i ndryshuar, kundërshtojnë njëri-tjetrin.

Duke pasur parasysh detyrimet ligjore, të ngarkuara nga ligji nr. 9244, datë 17.6.2004 “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”, i ndryshuar”, si dhe detyrat e lëna nga kontrolli i ushtruar në Drejtorinë e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës në këshillat e qarqeve të Shqipërisë, nga grupi i kontrollit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Tokës pranë Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe KLSH-ja, theksojmë se në situatën aktuale është pothuajse i pamundur krijimi i strukturave të Inspektoratit të Mbrojtjes së Tokës në qark.

Për sa më sipër, si dhe duke pasur këtë shqetësim prej vitesh nga mungesa e strukturës së Inspektoratit të Mbrojtjes së Tokës në qark, propozojmë të shikohet me përparësi, duke qenë se është edhe periudha e shqyrtimit të buxhetit, mundësia për përfshirjen e kësaj strukture në Drejtorinë e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës, si sektor brenda saj, duke shtuar fondet në buxhetin e deleguar për këtë drejtor. Gjithashtu, në ligjin e buxhetit do të propozonim ndryshimin e numrit 10 të personelit, pra heqjen e kufizimit të këtij numri, duke e çuar atë në 15. Këtu theksoj se buxhet e qarqeve mund ta përballojnë këtë lloj rritjeje. Shumë faleminderit!

Klotilda Bushka – Faleminderit, zonja Selami!

A ka ndonjë nga të ftuarit që e kërkoi fjalën dhe nuk e pati mundësi të fliste? Nuk ka.

Ndërkohë, ju njoftoj se shoqata tjetër e bashkive, me përfaqësues zotin Haxhimihali, i ka sjellë me shkrim komentet e saj në lidhje me projektbuxhetin e vitit 2024. Relatorët i kanë, ju lutem, sekretaria t’ua shpërndajë edhe anëtarëve të komisionit.

Unë do t’ia kaloj fjalën përfaqësuesit të Ministrisë së Financave, zotit Fran, në lidhje me ato që u folën për buxhetin, por edhe për problemet e tjera, që janë ngritur edhe vitin e kaluar. Më vjen mirë që borxhi i bashkive qenka ulur, por që vijon ende.

Fjala për ju.

Fran Brahimi – Përshëndetje të gjithëve!

Faleminderit, zonja kryetare!

Është kënaqësi ndodhem në këtë komision për të diskutuar sot për një...

Klotilda Bushka – Zoti Fran, nuk e keni mirë internetin! Dëgjohesh keq: ose hiqni kufjen, ose vendoseni më mirë!

Fran Brahimi – Dëgjohem? Po futem më mirë nga telefoni...

Klotilda Bushka – Zoti Fran, dëgjoheshit, por e mbyllët mikrofonin.

Tani jeni në rregull.

Fran Brahimi – Në lidhje me buxhetin e pushtetit vendor, siç u tha edhe nga parafolësit, këtë vit ka një rritje, le të themi të konsiderueshme, kryesisht të transfertës së pakushtëzuar. Nuk do t'i përsërit shifrat, sepse ato pothuajse u thanë. Kjo është rrjedhojë e një politike shumë të qartë, të mirë të të gjithë mekanizmit të financimit të pushtetit vendor, ku rregullat që janë vendosur, po shohim se kanë qenë të drejta dhe janë shumë të dobishme për buxhetin vendor.

Në anën tjetër, i mirëkuptoj të gjitha kërkesat që bënë kryetarët e bashkive, të cilat ishin kërkesa të përgjithshme dhe specifike. Ne jemi në procesin e diskutimit dhe të një debati të kahershëm për financat e pushtetit vendor, për mënyrën sesi financohet ky i fundit. Një pjesë e këtyre problemeve që janë ngritur sot, ne i kemi në agjendën e punëve të këtij viti dhe të vitit të ardhshëm.

Do të mundohem të prek disa aspekte që u ngritën nga kryetarët e bashkive, duke filluar me kryetarin e Bashkisë së Lushnjës, që me të drejtë ngriti një problem për financimin e mbledhjes dhe transportimit të mbetjeve urbane. Unë e shënova këtu, do të komunikoj, kam komunikuar dhe do të vazhdoj të komunikoj me Ministrinë e Mjedisit për këtë gjë përsëri pas këtij momenti. Për hir të së vërtetës, pak a shumë politikën e kësaj mbështetjeje buxhetore e ka bërë Ministria e Turizmit dhe e Mjedisit.

Po ashtu, problemin e pagave e tha Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore, po e them përsëri edhe unë, që kjo është diskutuar në Ministrinë e Financave. Problemi i pagave të qeverisë vendore do të shihet nga e para për ta parë të gjithë skemën e pagave, duke përfshirë edhe shqetësimet që ngriti kryetari i Bashkisë së Pogradecit. Meqenëse jemi te pagat, për vitin 2024 kemi një zë të veçantë të buxheti për financimin e pagave të administratës së njësisve të vetëqeverisjes vendore, ku qeveria ka marrë përsipër të financojë kryesisht pjesën e pagave minimale. Gjatë vitit 2024 është ndarë një fond i dedikuar vetëm për pagat e njësisve të vetëqeverisjes vendore, nëse do të ketë, dhe sigurisht që do të ketë një ndryshim të të gjithë sistemit të pagave për qeverisjen vendore. Të gjithë jemi të vetëdijsëm se problemi i pagave është një problem madhor, shumë i rëndësishëm i pushtetit vendor, i akumuluar ndër vite, gjë e

cila do të shikohet. Gjatë diskutimit të kësaj çështjeje do të shihen edhe fashat që i përmendi përsëri kryetari i Bashkisë së Pogradecit se çfarë fashash do të marrim në konsideratë apo nëse nuk do t'i marrim fare në konsideratë fashat.

Për sa u përket problemeve që lidhen me funksionet e deleguara, ato nuk janë tashmë funksione të deleguara, por janë funksione që i ka vetë qeverisja vendore. Sigurisht që ka një rritje, nuk mund të themi se ka një rritje shumë të madhe të buxhetit në raport me **vitin 2023, por nuk mund të themi (nuk kuptohet)....sepse në vitin 2016 vjen nga rritja e pagave**. Vetëm gjysma e kësaj rritjeje vjen nga rritja e pagave, pjesa tjetër është një rritje reale për shpenzimet për secilin nga këto funksione. *(nuk kuptohet)*

Ka disa vite që ngrihet problemi i rrugëve... Ato janë rrugë rurale, të cilat në vitin 2015, pas reformës administrative-territoriale, janë transferuar nga këshillat e qarqeve në bashki. I gjithë fondi i rrugëve rurale dhe buxheti që ndodhej në këshillat e qarqeve është lënë veçmas, pra nuk është i gjithë fondi, sepse i gjithë fondi i rrugëve rurale...*(nuk kuptohet)* tek transfertat që ju keni pasur në vitet e mëparshme. E mirëkuptoj që ka kërkesa, dhe janë normale kërkesat për rritjen e fondeve posaçërisht për rrugët rurale, por këto ishin mundësitë e këtij viti dhe këto mundësi janë shfrytëzuar në maksimum për t'i trajtuar këto funksione.

Duke marrë shkak edhe nga censi, i cili sigurisht që do të sjellë një hartë apo statistikë krejt të re për qeverisjen vendore, do të rishikohet nga e para e gjithë skema e financimit. Duke marrë shkas nga eksperiencat e akumuluar deri tani, kjo skemë do të rishikohet në frymën dhe nën dritën e shifrave të reja që do të dalin nga censi.

Në lidhje me borxhet, me të drejtë flitet për detyrimet që kanë bashkitë ndaj të tretëve. Sigurisht gjatë 2-3 vjetëve të fundit buxhetorë Ministria e Financave, me ato mundësi që ka pasur, i ka financuar një pjesë të këtyre borxheve, por duhet të jemi të vetëdijshëm që janë kontrata midis bashkive dhe të tretëve dhe buxheti i shtetit nuk i merr përsipër 100% këto, buxheti i shtetit sheh edhe në vitet e ardhshme buxhetore një mbështetje për këto borxhe, gjithsesi duhet të jemi të qartë se këto borxhe janë të bashkive. Ne e dimë që volumi i tyre ka rënë, por gjithsesi problemi është i vetë bashkive. Ministria e Financave e ka marrë në konsideratë, edhe unë e kam marrë në konsideratë dhe e di këtë problem dhe çdo vit e ngremë në diskutimet tona të brendshme në Ministrinë e Financave. Do të verifikoj dhe do të mundohem ta ndjek problemin që ngriti kryetari i Bashkisë së Pogradecit për pyjet. Me sa di unë, e kishte fjalën për zonat e mbrojtura, ku tarifata ose qiratë i përfiton tërësisht buxheti i shtetit dhe qeverisja

vendore nuk përfiton asgjë. Duhet ta shohim këtë dhe, nëse është e nevojshme, duhet të marrim një iniciativë për ta ndryshuar vendimin e qeverisë.

Së pari, duhet të diskutohet me ministrinë ose institucionin qendror që e ka këtë rregull, gjithsesi unë bie dakord me shqetësimin që ngriti kryetari i Bashkisë së Pogradecit.

Një problem tjetër që e ngriti edhe Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore, por po ju them edhe unë, se jemi duke e parë në kompleks, është problemi i financimit, duke filluar nga një iniciativë që është marrë nga ish-ministri i Standardeve, tashmë ministër i Shtetit për Çështjet Vendore, lidhur me hartimin e një kuadri rregullativ për standardet e shërbimeve publike në qeverisjen vendore. Këto standarde do të na tregojnë shumë për faturën financiare, se sa hapësirë kemi midis asaj që kemi dhënë, asaj që mbledh qeverisja vendore dhe asaj që do qeverisja vendore për ta ofruar shërbimin brenda një standardi mesatar, kombëtar për secilin nga shërbimet publike. Pra, është një problem që është adresuar te strategjia dhe te planet e punës së ministrive për ta parë si një problem të rëndësishëm për qeverisjen vendore, me qëllim që shërbimet publike të jenë vërtet të kostuara dhe të ofrohen brenda një standardi të pranueshëm kombëtar për të gjitha njësitë vendore, duke mos penguar që ato njësi vendore, të cila kanë kapacitetet dhe aftësitë fiskale e financiare, të mund ta ngrenë dhe ta ofrojnë me një cilësi ose një standard më të lartë, një standard të miratuar në nivel kombëtar.

Lidhur me qarqet, besoj se është një problem i qarqeve me Ministrinë e Bujqësisë. Problemi i qarqeve është i adresuar dhe te strategjia e decentralizimit për vitet 2023-2030 dhe, me sa di unë, do të jetë objekt i diskutimit të funksioneve dhe të gjithë funksionimit të këshillave të qarqeve.

Bashkia e Tiranës ngriti edhe problemin e tatimit mbi të ardhurat personale. Ne përdorim një skemë transitore, e cila është më e mira e mundshme. Ne shpërndajmë rreth 50% të buxhetit për pushtetin vendor, gjithsesi nuk ka qenë e mundur të bëhet një lidhje ose një investim te sistemet aktuale për të identifikuar taksapaguesin në nivel vendor, sepse edhe mënyra sesi është organizuar dhe janë të organizuara ndërmarrjet publike ose sh.a- të e ndryshme ka një problem teknik, ku të gjithë personelin e ka të regjistruar në Tiranë, bie fjala, sepse këtu ka edhe qendrën, ndërkohë që personeli është në bashki të ndryshme. Pra, ky është një problem teknik, që besojmë se do ta zgjidhim shumë shpejt, por jam shumë i sigurt se 99, 9% e mënyrës dhe e metodologjisë që përdoret për shpërndarjen e tatimeve mbi të ardhurat personale për njësitë e vetëqeverisjes vendore është e duhura, pra është e drejtë. Unë kaq kisha në lidhje me buxhetin vendor. Më

shumë u ndala te problematikat që ngritën njësitë e vetëqeverisjes vendore, përfaqësuesit, shoqatat. Jam i hapur nëse ka ndonjë problem që nuk i ktheva përgjigje, nëse e anashkalova apo nuk e përmenda.

Klotilda Bushka – Faleminderit, zoti Brahimi!

Besoj se i prekët të gjitha çështjet. Ne jemi duke i shqyrtuar nevojat, jemi në momentin që i dëgjojmë, i diskutojmë, do të kemi kohë edhe t'i sheshojmë.

Ndërkohë, e ka kërkuar fjalën për pyetje kolegia nga Komisioni i Ekonomisë, zonja Dhima. Zoti Xhoxhi, relatorëve do t'u japim fjalën në fund, pasi të dëgjojmë, të bëjmë dhe pyetjet, sepse pak a shumë ato që tha ministri do të thoshin relatorët. Sot është e rëndësishme t'i dëgjojmë shqetësimet e shoqatave të bashkive.

Zonja Dhima, fjala për ju.

Antoneta Dhima – Faleminderit, zonja Bushka, për organizimin e kësaj dëgjese! Në fakt, si një nga relatorët e projektbuxhetit kam kërkuar që të zhvillojmë një dëgjese me drejtuesit e institucioneve të vetëqeverisjes vendore, njëkohësisht me drejtuesit e shoqatave, të cilët paraqesin pranë komisioneve kërkesat e tyre në lidhje me buxhetin për vitin 2024 dhe buxhetin afatmesëm 2024 – 2026.

E falënderoj Ministrinë e Financave që gjatë gjithë këtyre ditëve ka qenë prezente dhe e okupuar për të dëgjuar çdo shqetësim që kemi si në lidhje me paketën fiskale, ashtu edhe me buxhetin!

Buxheti i pushtetit vendor është dyfishuar, krahasuar me atë të vitit 2015, kur është zbatuar reforma administrative-territoriale.

Unë do të përcjell dy shqetësime. Një nga shqetësimet e përcolli edhe kryetarja e Bashkisë së Lushnjës, zonja Sefa, dhe lidhet me mbështetjen për transfertën e pakushtëzuar sektoriale. Dihet që pushtetit vendor i ka kaluar në kompetencë menaxhimi i mbetjeve urbane. Duke parë tabelën e transfertës së pakushtëzuar të bashkive për vitin 2024, janë shumë qarqe që janë financuar për pjesën e menaxhimit të mbetjeve urbane. Asnjë nga 6 bashkitë e qarkut të Fierit nuk është financuar për këtë funksion, i cili u është deleguar njësitëve të vetëqeverisjes vendore. Kërkesa u është drejtuar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit. Në kushtet kur përfaqësuesit e Ministrisë së Financave janë prezentë shpresoj që, edhe me mbështetjen tuaj si komision, do të merret parasysh kjo kërkesë. Vlera që kërkohet është gati 73,4% miliardë lekë për të gjitha bashkitë e qarkut. Nëse do të më lejoni, po ju them në

mënyrë specifike: Bashkia e Fierit e ka 25, Lushnja e ka 19,2, Roskoveci e ka 4,2, Patosi e ka 5, Divjaka e ka 10, Mallakastra e ka 10. Pra, gjithsej vlera e financimit për menaxhimin e mbetjeve urbane për qarkun e Fierit shkon në 73,4 miliardë lekë. Po kështu, ka edhe një kërkesë tjetër: edhe në komisionet e tjera kur ne kemi bërë dëgjesa për buxhetin vit pas viti kam trajtuar edhe një shqetësim në lidhje me një funksion tjetër të deleguar, i cili ka të bëjë me administrimin e pyjeve. Bashkia e Patosit është një bashki, që e mbuloj si deputete e qarkut dhe për sa u përket sipërfaqeve të pyjeve që menaxhohen dhe administrohen fondi është i pamjaftueshëm për t'i përballuar shpenzimet për mirëmbajtjen e kësaj sipërfaqeje ose e këtij fondi pyjor. Bashkia i ka drejtuar kërkesë Komisionit të Ekonomisë, Ministrisë së Ekonomisë dhe kërkohet një vlerë prej 6 milionë lekësh për ta mbuluar këtë shërbim, i cili është transferuar dhe menaxhohet nga ana e kësaj bashkie. Janë këto 2 kërkesa që janë argumentuar dhe janë dokumentuar, e para nga të gjashta bashkitë e qarkut; e dyta, nga Bashkia e Patosit, e cila prej disa kohësh, më shumë se sa një muaj, ka drejtuar kërkesën për mbështetjen dhe për financimin e këtij funksioni të deleguar.

Të gjitha bashkitë që ishin prezente sot, ngritën shqetësimin edhe për nivelin e pagesave. Meqenëse zoti Brahimaj u shpreh që niveli i pagesave për njësitë e vetëqeverisjes vendore do të rishikohet, pasi është lënë një fond për këtë gjë, unë nuk po e trajtoj, edhe pse e kam si një shqetësim kryesisht të bashkive të vogla, që kanë burime të pakta financimi në drejtim të realizimit të të ardhurave, krahasuar me bashkitë e kategorisë së parë dhe duhet patjetër të mbështeten me më shumë grante, jo vetëm për transfertën e pakushtëzuar sektoriale, por edhe mbështetje për projekte të rëndësishme infrastrukturore, pse jo, edhe për zhvillimin e turizmit, pasi sektori i turizmit është një nga prioritetet e qeverisë shqiptare dhe duhet patjetër të mbështetet me fonde të mjaftueshme, jo vetëm për zhvillimin e infrastrukturës, por edhe nëpërmjet bujqësisë me projekte të rëndësishme që janë realizuar dhe janë të suksesshme në drejtim të ndërtimit të agroturizmit dhe përmirësimit të infrastrukturës, për të zhvilluar një turizëm dhe për të arritur objektivat për të arritur një numër të konsiderueshëm të vizitorëve në Shqipëri.

Edhe një herë, zonja kryetare, shumë faleminderit për mundësinë për të trajtuar dy probleme shumë specifike, shumë të rëndësishme, pasi qytetarët presin shërbime më të mira, punë më të mira, infrastrukturë më të mirë! Pavarësisht se opozita ka zgjedhur të mos jetë prezente në komisione dhe të reklamojë çdo ditë dhe më shumë që “miratojmë buxhetet në 5

minuta”, nga data 1 nëntor që jemi duke diskutuar buxhetin në komisionet parlamentare të përhershme, kemi bërë dëgjesa me grupet e interesit dhe vazhdojmë të punojmë për qytetarët dhe me qytetarët. Shumë faleminderit!

Klotilda Bushka – Faleminderit, zonja Dhima, për gjithçka që parashtruat, edhe për sqarimin e fundit! Duket që Komisioni i Ekonomisë e zotëron tamam informacionin për buxhetin dhe di t’u japë një përgjigje të saktë nevojave që u ngritën këtu. Më bëhet qejfi që ishit prezente.

A ka ndonjë koleg tjetër nga komisioni ynë apo nga Komisioni i Ekonomisë që kërkon fjalën?

Ndërkohë, do t’ia jap fjalën zotit Xhoxhi ose zotit Hasalla në cilësinë e relatorëve.

Po, zoti Xhoxhi.

Klevis Xhoxhi – Faleminderit, zonja kryetare!

I dëgjova me vëmendje të gjitha kërkesat dhe shqetësimet që u ngritën, qoftë nga ministri, por nga kryetarët e bashkive apo përfaqësuesit e shoqatave të bashkive dhe të këshillave bashkiakë. Është e vërtetë dhe i mirëkuptoj kërkesat e tyre për më shumë fonde buxhetore nga ato që janë rakorduar në këtë projektbuxhet, sepse kushdo prej tyre kërkon të ketë një shërbim më të mirë ndaj qytetarëve. Por, unë dua t’u rikujtoj kryetarëve të bashkive që, meqë janë në fazën e hartimit të projektbuxheteve të tyre vendore, të jenë pak më të kujdesshëm në adresimin e nevojave të qytetarëve, duke ruajtur raportin e shpenzimeve me investimet, sepse, në fund të ditës, ata janë zgjedhur nga qytetarët për të qenë menaxherë dhe administratorë të fondeve publike, që vijnë qoftë nga mbështetja e qeverisë, qoftë nga të ardhurat e veta.

Njëkohësisht, këtu gjej rastin t’u bëj thirrje prefektëve të jenë të vëmendshëm gjatë kalimit të buxheteve të bashkive, që të kalojnë një buxhet sa më efikas dhe eficient në shërbim të qytetarëve.

Më vjen mirë që decentralizimi dhe fuqizimi i qeverisjes vendore vazhdon të mbetet prioritet i qeverisë shqiptare, gjë që është parë edhe nga fondet që janë akorduar për pushtetin vendor, që janë rreth 3% e PBB-së, që do të thotë se kemi një rritje prej 10,4%.

Nga kërkesat dhe shqetësimet që parashtruan kolegët, u vu re që kemi kërkesa për fonde buxhetore, por kemi kërkesa dhe shqetësimet për rregullime ligjore. Bashkë me kolegët do t’i adresojmë sugjerimet dhe kërkesat për rritje të fondeve buxhetore te Ministria e Financave, te Komisioni i Ekonomisë, ndërsa kërkesat për rregullime ligjore do t’i shohim këtu, në Komisionin e Ligjeve, për të parë çfarë mund të sistemojmë dhe rregullojmë.

Nuk dua të zgjatem, sepse shifrat u thanë, mbështetja e qeverisë për pushtetin vendor u shpreh, ku u paraqitën shifrat nga ministri i Pushtetit Vendor, u paraqitën të gjitha të dhënat nga përfaqësuesi i Ministrisë së Financave. Kështu që, kolegë, mbetemi të hapur për çdo diskutim, çdo sugjerim dhe çdo adresim të shqetësimeve që ngritën kryetarët e bashkive dhe përfaqësuesit e shoqatave, bashkive dhe qarqeve. Faleminderit!

Klotilda Bushka – Faleminderit, zoti Xhoxhi!

Zonja Dhima ka kërkuar edhe një herë fjalën.

Antoneta Dhima – Zonja kryetare, unë dua të sqaroj kërkesën e bashkive për 73,4 milionë lekë. Ishte një lapsus, ndaj dua ta sqaroj edhe një herë.

Klotilda Bushka – Sa është shuma, zonja Dhima?

Antoneta Dhima - 73,4 milionë lekë kërkohen për transfertën sektoriale për 6 bashkitë e qarkut të Fierit te zëri “Trajtimi i mbetjeve urbane”, specifikisht për Bashkinë e Fierit 25 milionë, për Bashkinë e Lushnjës 19,2 milionë, për Bashkinë Roskovec 4,2 milionë, për Bashkinë e Patosit 5 milionë, për Bashkinë Divjakë 10 milionë dhe për Bashkinë Malakasatër 10 milionë. Te kërkesa që është bërë nga bashkitë nuk është specifikuar shuma, por është bërë kërkesa që, nëse ne dëshirojmë, mund të na japin shifra konkrete. Duke parë që shkresa nuk kishte shifra konkrete, unë u kërkova drejtuesve dhe kryetarëve të 6 bashkive të qarkut një shifër konkrete që ju, si komision përgjegjës, të përgatitni relacionin për Komisionin për Ekonominë dhe Financat.

Klotilda Bushka – Faleminderit, zonja Dhima!

Kush nga kolegët e do fjalën? Asnjë.

Atëherë, në mbyllje dua të bëj një përmbledhje.

Unë e konsideroj shumë të vlefshme këtë dëgjese. T’ju them të drejtën sa herë diskutojmë dhe shqyrtojmë projektligjin “Për buxhetin e shtetit” dëgjesa me përfaqësuesit e bashkive është një nga më të rëndësishmet, sepse bëhet fjalë për ato institucione që janë më pranë qytetarëve dhe ofrojnë shërbime në nivel vendor. Duhet të dëgjohen nevojat dhe mangësitë që kanë, sfidat që hasin përditë. Shoh që nga viti në vit ka përmirësime në drejtim të zgjidhjes së shqetësimeve dhe problemeve që kanë pasur, por problemet janë ende dhe ne do të duhet t’i adresojmë.

Nga dëgjesa vë re që një pjesë e shqetësimeve lidhen me projektligjin e buxhetit, një pjesë tjetër lidhen me funksionet që ata kryejnë në nivel vendor dhe ka nevojë për një vlerësim.

Duke qenë se zoti Mazniku është ministër për Pushtetin Vendor, mendoj se 10 vjet pas reformës, siç e thatë edhe vetë, është e nevojshme një analizë, që të kuptojmë si ka funksionuar administrimi i territorit në nivel vendor, si ka qenë performanca e bashkive, si ka qenë aftësia e bashkive për të menaxhuar financat, sa eficiente kanë qenë bashkitë në ofrimin e shërbimeve, në varësi të shpenzimeve që ata kryejnë, sa kapacitete njerëzore kanë dhe sa aftësi kanë ato për të ofruar shërbime të njëjta në çdo pjesë të territorit. Mendoj se për këtë vlerësim edhe ju do të keni nevojë për financa, për stafe, nuk e di, mbase do të punoni me donatorë, por është e nevojshme që të kemi një vlerësim të tillë, për të kuptuar se ku jemi.

Unë këtë do ta kërkoj sot në emër të komisionit, besoj se e keni në planet tuaja. Në momentin që do ta kryeni, do ta nisni ose do ta realizoni, sepse nuk është një proces i lehtë, por një proces sfidues, që kërkon kohën e vet, kërkon ekspertizë, dhe, nëse do të keni nevojë për mbështetjen e komisionit, na vini në dijeni, sepse jemi të gatshëm t'ju ndihmojmë, por kemi nevojë për një vlerësim thelbësor, për të kuptuar se si ka funksionuar pushteti vendor në tërësi dhe çfarë është e nevojshme, që edhe ne të ecim përpara duke ndihmuar bashkitë, me qëllim që atje ku ka mangësi t'i plotësojmë, atje ku ka rezultate pozitive t'i replikojmë në çdo bashki të vendit. Ndërkohë, kjo le të diskutohet edhe ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, relatorëve dhe zotit Mazniku, nëse ka nevojë nga buxheti i shtetit për realizimin e një vlerësimi të tillë.

Sa i takon buxhetit në përgjithësi, unë do t'i ftoj relatorët, bashkë me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, që t'i marrin pikë për pikë të gjitha këto që u diskutuan sot, dhe komentet me shkrim që ka sjellë Instituti i Bashkive të Shqipërisë, që të bëhet një raport më vete, një aneks i raportit të Komisionit të Ligjeve për Komisionin e Ekonomisë për çështjet që u ngritën dhe ato që prekin si buxhetin, ashtu edhe kompetencat e pushtetit vendor, pra të jetë një aneks i raportit tonë. Ne do t'i kushtojmë rëndësi çdo çështjeje, duke e parë në detaje jo vetëm nga ana financiare, por edhe nga ana e nevojave. Fjala vjen, nëse këtu ngrihet shqetësimi që ka një tavan për pagat, i cili nuk tërheq ekspertë të mirë në nivel vendor për të kryer funksione, siç e tha edhe kryetari i Bashkisë së Pogradecit për çështjen e arkitektëve, po e marr si shembull, atëherë kjo duhet të rishihet, megjithëse nuk ka të bëjë shumë me buxhetin, por me kuadrin ligjor që kemi.

Niveli i pagave sot në bashki a përkon me realitetin që kemi në administratën publike, me reformën që kemi bërë për rritjen e pagave, që buxhetohet edhe për vitin 2024? A kemi nevojë ta

rishikojmë këtë dhe çfarë duhet bërë? Kjo është një analizë, që besoj se edhe ministri Mazniku do ta ketë në konsideratë. Mirë është të fillojmë t'i trajtojmë këto çështje që në këtë raport, sepse diku duhet ta nisim dhe ne, si komision, do të duhet ta ndjekim, ta monitorojmë dhe ta mbështesim më vonë. Kështu që, unë sugjeroj ta kemi si çështje në raport.

Lidhur me borxhin publik, unë shoh që borxhi publik i bashkive është ulur, por ekziston ende. Unë nuk i paragjykoj pretendimet tuaja, jam e bindur që ju e njihni shumë mirë pushtetin vendor dhe nevojat që keni, por logjika është që, nëse të ardhurat vijnë nga bashkitë, bie fjala, nga dhënia me qira e sipërfaqeve të zonave të mbrojtura dhe ato nuk u kalojnë bashkive ose një pjesë e tyre, atëherë kjo duhet riparë, se kjo e ardhur mund të ndihmojë vërtet në financimin e një shërbimi apo në mbulimin e borxheve të prapambetura.

Sa i takon nivelit të investimeve, sepse nga zonja Farrici më mbeti në mendje fakti që është buxhetuar pushteti vendor sa i takon rritjes së pagave apo pagave të shtuara në sektorë të ndryshëm, siç është arsimit parauniversitar, apo, nëse nuk gaboj, për çerdhet dhe kopshtet, por niveli i investimeve nuk është në proporcion të drejtë. Edhe kjo duhet parë në raport.

Lidhur me mbulimin e nevojave për rrugë rurale, për transportin e mbetjeve në vendet e depozitimit, në *landfille* apo diku tjetër, sigurisht që kjo duhet parë. Zoti Brahimi, ne nuk mund t'i lëmë bashkitë të marrin para nga fondet e tjera për shërbime lokale dhe t'i japin në këtë drejtim. Nëse kjo është e pamjaftueshme, kjo duhet të kihet në konsideratë, pra duhet të vlerësohet nga ana juaj.

Unë po i trajtoj me pika ato që dëgjova nga parashtrimi gjatë dëgjësës, por përgjithësisht do të doja që të gjitha çështjet që u ngritën këtu të trajtoheshin mes Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, ministrit të Pushtetit Vendor dhe relatorëve, që të kemi një sqarim të çdonjërës prej tyre, që të jenë pjesë e raportit dhe më pas të rakordojmë për sugjerimet tona për Komisionin e Ekonomisë.

Ajo që vë re është se ne kemi një grant të rritur për pushtetin vendor, pra, përveç transfertës së pakushtëzuar dhe të ardhurave të veta prej 71,1 miliardë lekësh, në portofolin e buxhetit vendor, ku përfituese janë vetë bashkitë, parashikohen edhe 15,3 miliardë lekë, që alokohen nga ministritë e linjës dhe institucionet qendrore. Pra, në buxhetin e vitit 2024 nuk është vetëm transfertat e pakushtëzuar, por janë edhe ato para që u jepen bashkive, bie fjala, për investime, për rikonstrukcion dhe ndërtim ujësjellësish në vlerën 4,5 miliardë lekë apo investime nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit; për infrastrukturën vendore dhe rajonale jepen 4 miliardë lekë;

jepet fond për emergjencat civile për bashkitë në shumën 2,5 miliardë lekë për financimin e projekteve lidhen me parandalimin e fatkeqësive natyrore dhe digat; jepen fonde për investime, për rikonstrukcion, për ndërtim, për rehabilitim shkollash 9-vjeçare dhe të mesme në vlerën 2,2 miliardë lekë; jepen fonde për investime në ujitje dhe kullim 400 milionë lekë. Te fondi social kam përshtypjen është 6-përqindëshi i ndihmës ekonomike në vlerën 320 milionë lekë. Ndërsa sa i takon turizmit, do të ketë fond për pastrimin e bregdetit, që shtrihet në të gjitha bashkitë e vijës bregdetare, ky fond do të menaxhohet nga Ministria e Mjedisit dhe do të jetë në vlerën 300 milionë lekë. Edhe këto janë përfitime të bashkive, por që jepen nga ministritë e linjës.

Thënë këtë, unë do të doja që në raportin tonë t'i kushtonim shumë rëndësi çdo çështjeje që u ngrit këtu, edhe nëse ka mbetur ndonjë gjë pa u thënë, ne kemi kohë derisa të diskutojmë në komision buxhetin nen për nen, që t'i ndihmojmë bashkitë tona t'i kryejnë sa më mirë funksionet e tyre, por, nga ana tjetër, edhe bashkitë duhet ta rrisin performancën e tyre në ushtrimin e funksioneve.

Para se ta mbyllim këtë pikë, po ia kaloi fjalën zotit Mazniku, në cilësinë e ministrit të fushës.

Arbian Mazniku – Shumë faleminderit për pikat që ngritët, zonja Bushka!

Siç e thatë edhe ju, bërja e një analize është një prioritet i institucionit dhe tashmë ka filluar puna me një seri partnerësh, që kanë punuar në pushtetin vendor, por edhe nëpërmjet Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore për vlerësimin e një serie indikatorësh të performancës së bashkive si nga ana financiare, nga ana e burimeve njerëzore, ashtu edhe nga ana e ofrimit të shërbimeve.

Ne do të vijmë në komision pranverën e vitit që vjen me raportin e bërë gati, pas një pune intensive në 6 bashki, ku do të kemi mundësi të bëjmë një diskutim tërësor për çështjen e kompetencave bashkiake, për nevojën për mbulime legjislative (nëse do të ketë nevojë), që t'ua lehtësojmë punën bashkive në performancën e këtyre kompetencave dhe në aktet nënligjore respektive për të parë nëse do të ketë nevojë për elemente dhe ristrukturim financiar, që ato të kenë mundësi t'i ofrojnë këto shërbime.

Së dyti, do të kemi edhe një analizë të detajuar të kapaciteteve të bashkive në aspektin financiar. Besoj se do të jetë momenti i duhur përgjatë pranverës së vitit 2024 për të hapur një diskutim tërësor për vlerësimin e një sërë elementesh të çështjeve që u prekën gjatë diskutimit si: taksat e ndara, renta minerare, skema apo formula e financimit. Pra, ne do të hapim një diskutim

tërësor me bashkitë, si palë të interesuara, me shoqatat, më pas do të kemi mundësi të vijmë te ju me një seri propozimesh, për të bërë një debat dhe për të parë ndryshimet e nevojshme (nëse do të vlerësohet që do të ketë ndryshime), duke ndjekur më pas rrugën e një procesi legjislativ.

Faleminderit!

Klotilda Bushka – Faleminderit, zoti Mazniku!

Më vjen mirë që e keni në plan që në mars të kemi një vlerësim në lidhje me çështjet e pushtetit vendor, sepse është shumë e rëndësishme.

Siç e thashë në këtë dëgjese, ne vërtet flasim për buxhetin e 2024-ës, por bashkitë kanë mundësi të shprehin të gjitha shqetësimet që lidhen me përmirësimet ligjore, me koordinimin apo me të kuptuarit e situatave, që ndoshta mund të jenë në ligj, por nuk zbatohen realisht në praktikë. Kështu që, do të ishte shumë e nevojshme që ta bënit këtë vlerësim dhe ne, si komisioni përgjegjës për pushtetin vendor, të hyjmë në një proces, që të shohim se si t'i përmirësojmë sa më shumë funksionet e bashkive dhe t'i ndihmojmë ato, që në fund t'u shërbejnë sa më mirë qytetarëve. Qëllimi i të gjithëve është që qytetarët të përfitojnë sa më shumë, ne të kemi një performancë eficiente nga pushteti lokal dhe të prevalojë interesi publik.

Duke qenë se nuk e kërkon njeri fjalën, ju njoftoj se sot kemi mbaruar dëgjesën e 22-të për shqyrtimin e projektligjit “Për buxhetin e vitit 2024”. Në bazë të miratimit në parim të projektligjit Komisioni i Ligjeve ka kryer 22 dëgjesa me institucionet e drejtësisë, institucionet e pavarura dhe ato kushtetuese, këtu futet edhe dëgjesa e sotme, si dhe dëgjesa me administratën publike, pra me ato institucione që janë në fushën e përgjegjësisë së këtij komisioni.

Gjatë kësaj kohe relatorët, Ministria e Financave dhe institucionet kanë rakorduar në lidhje me nevojat e institucioneve dhe saktësimet e atyre që do të dakordësohen që ky komision t'i marrë në shqyrtim në mbledhjen e radhës, që do të jetë për miratim nen për nen dhe në tërësi të projektligjit “Për buxhetin e vitit 2024” dhe do të hartojë raportin e tij me sugjerimet përkatëse për komisionin përgjegjës, Komisionin e Ekonomisë dhe Financave.

Unë dua të falënderoj të gjithë të ftuarit, të gjithë kolegët, relatorët, teknikën që na mundëson realizimin e mbledhjeve me mjetet e komunikimit elektronik, sekretarinë e komisionit!

Ju uroj një ditë të mbarë!

Sapo të jenë gati relatorët dhe Ministria e Financave ne do të njoftojmë mbledhjen e radhës për miratimin nen për nen dhe në tërësi të buxhetit.

Shumë faleminderit edhe një herë!

Ditë të mbarë!

MBYLLET MBLEDHJA